



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 23457.....Prot.

Tiranë, më 28.10.2025

V E N D I M

Nr. 272 Datë 28.10 2025

PËR

**RISHPALLJEN E KONKURISIT PËR PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË
PJESSHME, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË
REHABILITIMIT PRANË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Kreu VI, PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, në VKM nr. 123, datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës", në shkresën e Dekanit të FSHR me nr. 2345/6 prot., datë 27.10.2025, "Kërkesë për rihapjen e konkursit për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme në FSHR", Rektori,

V E N D O S I:

Rishpalljen në Web-in [http:// www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) të procedurave të aplikimit për personelin akademik me kohë të pjesshme në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit si më poshtë :

I. DEPARTAMENTI KINEZIOLOGJISË

1 (një) Lektor

- Lënda : "Dhimbja, Menaxhimi dhe Rehabilitimi"
- Moduli : "Trajtimi medikamentoz i dhimbjes në dëmtimet Muskuloskelatare",
(M.Profesional)

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për "Lektor" për Lëndën: "Dhimbja, Menaxhimi dhe Rehabilitimi" për Modulin: "Trajtimi medikamentoz i dhimbjes në dëmtimet Muskuloskelatare", në Departamentin e Kineziologjisë janë si më poshtë:

II. KRITERE TË PËRGJITHSHME

I	KRITERE ELIMINUESE
1	Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
2	Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurron;
3	Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
4	Të mos ketë prishur imazhin e UST-së;
5	Të mbajë të paktën gradën shkencore “Doktor”. (Grada shkencore e mbrojtur në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
6	Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës
<i>Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.</i>	

Kritere specifike:

1. Të ketë kryer studimet e larta universitare për “Farmaci” me notën mesatare mbi 8 (tetë).
2. Kandidati duhet të mbajë të paktën gradën shkencore “Doktor”.
3. Të ketë të paktën 2 (dy) vite pune në mësimdhënie në IAL, brenda ose jashtë vendit sipas modulit të përcaktuar.
4. Të ketë kryer aktivitete shkencore si: referime, botime brenda dhe jashtë vendit.
5. Vlerësohen specializime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së Farmacisë.
6. Të ketë të paktën 2 (dy) referenca nga profesorë të fushës.

Kritere preferenciale:

1. Kanë preferencë kandidatët që kanë kryer kualifikime kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me fushën e Farmacisë.

III. Kandidatët që do të aplikojnë për këto vende pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

- a) Formular aplikimi;
- b) Letër motivimi dhe shprehje interesi për lëndën/modulin që kandidati aplikon.
- c) Një kopje jetëshkrimi i fokusuar në eksperiencat në mësimdhënie dhe botime shkencore;
- d) Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- e) Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar, sipas plotësimit të kriterëve të shpallura;
- f) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti/ formulari i vetëdeklarimit);
- h) Vërtetim nga qendra e punës për t’u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme në institucionin tonë. (n.q.s është i punësuar e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon. (dorëzohet nëse shpallet fitues)
- i) Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

IV. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

Dokumentacioni i plotësuar sipas kriterëve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, duhet të dorëzohet në adresën e përcaktuar në njoftim që është:

- Dorëzimi i dokumentacionit në **rruge elektronike ne web-site te UST-se dhe në mënyrë postare**;
- Vetëm paketat e aplikimit të mbërritura me anë të aplikimit elektronik ose shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Njësia Kryesore, Njësia bazë, **specialiteti ku aplikon**, emri, mbiemri.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

V. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 5 (pese) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit. Kandidati duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pese) ditëve punës nga data e publikimit të njoftimit dhe e dorëzon atë të mbyllur në zarf me rrugë postare ose te gjithë paketen me dokumenta e dergon elektronikisht ne web-site te UST .

- VI. Të pranohet si kandidaturë qoftë dhe kur paraqitet vetëm një dosje, me kusht që kandidati të plotësojë kriteret.
- VII. Deri në datën 05.11.2025, të ngrihet pranë Departamentit, Komisioni ad-hoc, i cili brenda datës 07.11.2025 duhet të vlerësojë dosjet e paraqitura. Pas shpalljes së listës me kandidatët vlerësues, afati i pritjes së ankesave është 2 (dy) ditë pune.
- VIII. Departamenti përkatës në bashkëpunim me Komisionin ad-hoc është përgjegjës për ruajtjen dhe arkivimin e dosjeve si dhe të kontratave të lidhura me kandidatët fitues.
- IX. Dekanati i FSHR-së, përcjell listën përfundimtare brenda datës 12.11.2025, për miratim në Rektorat.
- X. Për zbatimin e Vendimit, ngarkohen: Zv.Rektori i anës mësimore, Dekani i FSHR, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit si dhe Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për shpalljen dhe hedhjen e të dhënave në *Web-in* <http://www.ust.edu.al>.
- XI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Agron KASA

